



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7089/2025

A.nr.1572/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1572/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesi SH.K nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1572/2025, e datës 11.08.2025, e parashtruar nga ankuesi SH.K.

II. Anulohet konkursi i datës 14.05.2025, për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme i shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke ndërmarr veprimet sipas pikës II të këtij dispozitivi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, SH.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 11.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultatit përfundimtar dhe procesit të rekrutimit për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe mos vlerësimit në përputhje me kriteret, në shkeljet e parimeve, rregullave dhe trajtimit jo të barabartë me kandidatët tjerë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje SKGJK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.09.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 22.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6298/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1572/2025 të datës 11.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5343/2025, e datës 11.08.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 6298/2025 të datës 22.09.2025 për vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës; Njoftimin për rezultatet përfundimtare i datës 17.07.2025; Njoftimin për rezultatet e testit me shkrim datë 04.07.2025; Njoftimin e datës 17.07.2025 për rezultatet përfundimtare për Administrator në Gjykatën Supreme të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 02.09.2025; Formularin e vlerësimit të intervistës me gojë nga komisioni datë 17.07.2025; Listën e shqyrtimit të aplikacioneve datës 20.06.2025; Njoftimin për test me shkrim; Vendimin KGJK.nr.147/2025 të datës 08.05.2025 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin KGJK.nr.150/2025 të datës 08.05.2025 për themelimin e komisionit të rekrutimit për Administrator të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Dekretin/kontratën/akt emërimit e anëtarëve të komisionit; Konkursin për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për secilin kandidat datë 17.07.2025; Testin me shkrim i datës 04.07.2025; Njoftimin për intervistë me gojë i datës 11.07.2025; Aplikacionin e kandidatës D.M i datës 11.06.2025 me dokumentacionin prej 35 faqe; Aplikacionin e ankuesit i datës 09.06.2025 me dokumentacionin prej 93 faqe.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se SKGJK më datë 14.05.2025, ka shpallur konkursin për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, duke ju nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë dhe nga rezultati i përgjithshëm është vlerësuar me gjithsej 68.8 pikë.

Pas përfundimit të procedurës, SKGJK, më datë 17.07.2025, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare ku rezulton se kandidatja D.M është vlerësuar me 73.4 pikë që nga të gjithë kandidatët ka marr më së shumti pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultatit përfundimtar dhe tërë procesit, pretendon se nga rezultati i testit me shkrim kam marr 59.5 pikë si i pari në listë, ndërsa në intervistë me gojë jam vlerësuar me 9.3 pikë, ndërsa kundër kandidatja në testin me shkrim ka pasur 52 pikë, kurse në intervistë me gojë është vlerësuar me 21.4 pikë. Pretendon se vlerësimi i kandidatëve nga intervistat bëhet menjëherë pas përfundimit të intervistimi kështu që nuk ka ndodhur ngase intervista është mbajtur më datë 17.07.2025, ndërsa vlerësimi është bërë më datë 18.07.2025, dhe ka dallim mes pikëve nga vlerësimi individual i anëtarëve të komisionit gjatë intervistës dhe vlerësimit të pikëve në ditën e nesërme që ka qenë në dëm timin, andaj si është e mundur që në testim me shkrim të marr 85% të pikëve ndërsa në intervistë me gojë vetëm 30% të pikëve kur dihet se sa kam qenë i suksesshëm në intervistë. Shkelje tjetër është se nuk kam vërejtur që është ftuar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të mbikëqyrë sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Është vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr. 16/2024, ngase nuk janë respektuar parimet e përgjithshme të rekrutimit dhe përzgjedhjes për këtë pozitë. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet në tersi rezultati përfundimtar për këtë pozitë.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh Vendimin KGJK.nr.147/2025 të datës 08.05.2025, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës përmes të cilit vendim është hequr kriteri i përvojës së punës në pozita drejtuese për pozitën administrator në gjykata, konstaton se kriteret e përgjithshme që një kandidat duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si administrator janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë sipas legjislacionit në fuqi; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të ketë diplome universitare të vlefshme në Kosovë në ndonjë nga fushat: Juridik, Ekonomi apo Administratë Publike; 1.9. përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijim: 1.10. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“4.Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor rrjedhë se të punësuarit në administratë të sistemit gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë dhe se mbi këtë bazë ligjore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e rekrutimit, përzgjedhjes dhe themelimin e marrëdhënies së punës për administratorë/zëvendës administrator të gjykatave, gjegjësisht me Rregulloren Nr.16/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë/zëvendës administrator të Gjykatave.

Ndërlidhur me konstatimin si më sipër, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Rregullores Nr.16/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë/zëvendës administrator të Gjykatave, me theks të veçantë: Nenit 8 paragrafi 1, ku përcaktohet: *“I.Kriteret e përgjithshme që një kandidat duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si administrator janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 6/16 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse në pikëpamje shëndetësore; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore sipas legjislacionit në fuqi; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; 1.8. të ketë diplome universitare të vlefshme në Kosovë në ndonjë nga fushat: Juridik, Ekonomi apo Administratë Publike; 1.9. përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijim: 1.9.1. tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese; ose 1.9.2. dy (2) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master); ose 1.9.3. një (1) vit përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës)”*

Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përmes Vendimit KGJK.nr.147/2025 të datës 08.05.2025,ka vendosur : *I. Kriteri i përvojës për pozita drejtuese si kusht formal për përzgjedhje në pozitën administrator në gjykata hiqet, II. Ndryshimet konform pikë I të këtij vendimi të reflektohen në aktet normative.III.Obligohet Sekretariati i Këshillit Gjyqësor,për zbatimin e këtij vendimi.IV.Vendimi hy në fuqi me datë 08.05.2025.* Përkitazi më këtë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, bazuar në këtë vendim edhe ka bërë shpalljen e konkursit për pozitën e cekur më lartë, ndërsa akti normativ sipas këtij ndryshimi sipas këtij vendimi është miratuar më datë 30.09.2025 në mbledhjen e mbajtur të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se përderisa marrëdhënia e punës së të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor në këtë rast gjykatave është e rregulluar me akte të veçanta respektivisht me rregullore përkatëse, e në këtë rast pranimi i pozitave të administratorëve në gjykata është e rregulluar me rregulloren përkatëse, Rregulloren Nr.16/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe

Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë/zëvendës administrator të Gjykatave, atëherë në referim për çështjen konkrete, Kolegji i Këshillit, me rastin e vendimmarrjes mori për bazë Aktgjykimin P.A.nr. 12/2025 të Gjykatës Supreme të Kosovës e cila konstaton: *“Gjykata ndonëse nuk ka kompetencë shqyrtimin e akteve administrative, megjithatë përkitazi me pretendimet mbi korrigjimin e gabimeve teknike të Rregullores (ZKM)–Nr.04/2025, përmes vendimit nr.prot.349/2, të datës 08.04.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, kjo gjykatë vlerëson se aktet nënligjore normative nuk mund të korrigjohen, përmirësohen apo ndryshohen përmes akteve administrative, andaj edhe i njëjti nuk mund të i nënshtrohet shqyrtimit si pjesë përbërëse e aktit nënligjor normativ, njëherit është jashtë kompetencave të sekretarit të përgjithshëm, pasi ndërhyr në një rregullore të miratuar dhe publikuar nga Kryeministri. Çdo ndryshim në përmbajtjen e akteve normative kërkon ndjekje të procedurës së përcaktuar ligjore – formale”*. Rrjedhimisht duke marr parasysh këtë konstatim gjyqësor, Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje që Këshilli Gjyqësor i Kosovës është autoritet për ndryshimin e akteve nënligjore të këtij institucioni, mirëpo konkursi për pozitën në fjalë nuk është shpallur si rezultat i ndryshimit të aktit nënligjor por është shpallur si rezultat i një akti administrativ siç është Vendimi KGJK.nr.147/2025 i datës 08.05.2025 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Edhe pse ndryshimet sipas Vendimit KGJK.nr.147/2025 të datës 08.05.2025 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, janë reflektuar në Rregulloren Nr.11/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 16/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë/zëvendës administrator të Gjykatave, por se ky akt nënligjor që reflekton këto ndryshime sipas nenit 3 të kësaj rregullore hy në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht më datë 30.09.2025, rrjedhimisht krijimi i pasojave juridike ndërlidhet me këtë datë të aprovimit, andaj, ndërlidhur me at që u tha si më lartë Kolegji i Këshillit, vlerëson se konkursi nuk është është shpallë mbi bazë të ndryshimeve në aktin nënligjor.

Bazuar në konstatimet si më lartë, në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se procedura e pranimit për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk ka mbështetje ligjore në kuptim të konstatimeve si më sipër dhe mbi këtë bazë anulohet konkursi i datës 14.05.2025, për pozitën Administrator në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme i shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i obliguar që në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1572/2025, datë 29/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit SH.K;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.